

Prishtinë, Kosovë

21 dhjetor 2017

**Drejtuar:** Avdyl Lipoveci, Ministria e Diasporës, Departamenti për Ruajtjen dhe Kultivimin e Arsimit dhe Kulturës në Diasporë

**Nga:** OJQ Germin

**Tema:** Mësimi plotësues i gjuhës amtare në Diasporë

I nderuar z. Lipoveci,

Më 11 dhjetor 2017, organizata jo-qeveritare Germin, në kuadër të iniciativës *Dialogu i Strukturuar për të Drejtat e Diasporës* ([www.diasporaflet.org](http://www.diasporaflet.org)) ka mbajtur takim virtual me temën "Mësimi plotësues i gjuhës amtare në Diasporë", ku ishit prezent edhe ju.

Paneli diskutues:

1. Rozana Hykaj, mësuese nga shoqata "Arbëria", Mbretëria e Bashkuar;
2. Hazir Mehmeti, mësues, Austri;
3. Fjolla Vukshinaj, organizata Germin, Kosovë;
4. Beqir Cikaqi, mësues nga "Shkolla Shqipe në Treviso", Itali;
5. Avdyl Lipoveci, Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Kosovë;

Diskutimi u moderua nga Kushtrim Ahmeti, gazetar në Kohavision, Prishtinë.

Mësimi plotësues i gjuhës shqipe në Diasporë vlerësohet si një proces mjaft i rëndësishëm, ngase strategjia qëndron në aspektin e ruajtjes së identitetit kombëtar. Gjuha, edhe pse mbetet një ndër faktorët për mbijetesën e komunitetit shqiptar jashtë Kosovës, vitet e fundit ky proces është përballur me shumë sfida dhe përgjegjësi. Në anën tjetër, duke e konsideruar diasporën, si shtyllë mbështetëse për zhvillim ekonomik për një kohë të gjatë për vendin tonë, ruajta dhe forcimi i lidhjeve vazhdon të mbetet shumë i rëndësishëm për të dy palët.

Por, bazuar në situatën e tanishme, mësimi plotësues i gjuhës amtare në Diasporë, ka ende telashe serioze për aplikim e kriterëve të larta. Kryesisht ato kanë të bëjnë me mbulimin financiar të këtij programi në të gjithë diasporën, por edhe kualifikimin adekuat të mësimit plotësues. Për këtë, Germin hapi një debat në lidhje me shqetësimet dhe mundësitë që Qeveria e Kosovës dhe Shqipërisë duhet t'i adresojnë në përmirësimin e gjendjes së mësimit plotësues për shqiptarët jashtë vendit.

Për këtë, ne po ju dërgojmë disa nga rekomandimet e dala nga ky diskutim:

- Të përditësohen librat dhe materialet e tjera pedagogjike për arsim bazuar në nevojat e gjeneratave të ndryshme, dhe kësaj programi të zhvillohet me metoda dhe mjete duke ju përshtatur niveleve të ndryshme të arsimit, në mësimdhënie dhe mësim nxënie;
- Shërbimet diplomatike në vendet pritëse të promovojnë avancimin e mësimit plotësues në Diasporë;
- Të saktësohet me ligjin e ri të Diasporës, të iniciuara nga Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë, financimi i mësimit plotësues duke përfshi kualifikimin e mësimit plotësues shqiptarë në Diasporë;

- Të saktësohet me ligjin e ri të Diasporës, të iniciuar nga Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë, se a do t'ju njihet përvoja e punës mësuesve shqiptarë, si do të jetë raportimi dhe si do të bëhet lëshimi i dokumentacionit pas mbarimit të vitit shkollor;
- Qeveria e Kosovës dhe Shqipërisë të përkrahë projektet shkencëtare dhe hulumtuese në fushën e arsimit plotësues në Diasporë;
- Qeveria e Kosovës dhe Shqipërisë të dërgojë atashe në vendet pritëse, të cilët do të kujdesen për mbarëvajtjen e mësimin plotësues në Diasporë;
- Të krijohet një mekanizëm i përbashkët nga të dyja Qeveritë për këshillimin dhe mbikëqyrjen e mësimin plotësues në Diasporë.

Pasi problemet për mësimin e gjuhës shqipe në diasporë janë edhe më të thella, ndërsa zotimet për përmirësime nuk kanë fund, paneli diskutues dhe publiku potencoi se diaspora kërkon politika konkrete kombëtare përtej seminareve të organizuara nga qeveria e Kosovës dhe Shqipërisë. Për këtë, shpresojmë që marrëveshja e arritur për mësimin e gjuhës amtare, e cila obligon dy shtetet të formojnë një kurrikulë unifikuese për nxënësit shqiptarë dhe financimin e përbashkët të gjuhës amtare, do të sjellë përmirësime në këtë drejtim.

Po ashtu, Germin ka krijuar Task Forcën "Shkëmbimet edukative dhe kulturore", me profesionistë të ndryshëm nga diaspora, të cilët janë duke punuar në një Plan të Veprimit, që përfshinë edhe sfidat dhe rekomandimet ndaj mësimin plotësues në Diasporë.

Shpresojmë që pikat e përmendura më lartë do të hapin një diskutim më të gjerë rreth gjuhës amtare.

Me respekt,

Liza Gashi, Drejtoreshë e Programeve

